

V E N D I M
Nr. 358, datë 28.7.1999

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE
TË DOGANAVE

(Ndryshuar me VKM nr. 380, datë 14.7.2000; nr. 431, datë 11.6.2001)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Për punonjësit e doganave, skema e strukturës së pagës është sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

a) *Paga e drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave bëhet 61 301 lekë në muaj.*

b) *Paga e zëvendësdrejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave bëhet 43 778 lekë në muaj.*

II. Struktura e pagës mujore përbëhet:

1. Paga e grupit sipas nivelit arsimor të kërkuar nga vendi i punës:

- Paga e grupit I	“1”	Diplomë e shkollës së lartë
- Paga e grupit II	“2”	Diplomë mbi shkollën e mesme
- Paga e grupit III	“3”	Diplomë e shkollës së mesme
- Paga e grupit IV	“4”	Dëftesë lirimi (arsimi 8-vjeçar)

Diploma mbi shkollën e mesme konsiderohen të gjitha diplomat e kurseve me program mësimor të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur në legjislacionin në fuqi. Në këtë grup përfshihen, gjithashtu, të gjithë ata të cilët kanë mbaruar 2 vite akademike të shkollës së lartë.

Pagat për çdo grup pune janë sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shtesa për vjetërsi në punë, në profil, jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

3. Shtesë kualifikimi. Kjo shtesë jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit në përqindje, si vijon:

- Në masën 5 për qind, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së tretë.
- Në masën 10 për qind, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së dytë.
- Në masën 20 për qind, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së parë.

Në rastin e punonjësve të doganave kjo kolonë është bosh dhe do të plotësohet me përcaktimin e standardeve dhe niveleve të kualifikimit, në një të ardhme.

4. Shtesa e pozicionit është përcaktuar për çdo vend pune sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Shtesa për kushte pune është përcaktuar për çdo vend pune sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Deri në fund të vitit 1999, doganierët pa arsim përkatës, të zëvendësohen me punonjës me arsim të lartë, sipas kërkesave të Kodit Doganor.

IV. Ngarkohet Ministria e Financave që, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatimin e këtij vendimi.

V. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 437, datë 3.9.1993 “Për pagat e punonjësve të tatimeve dhe doganave” për pjesën e punonjësve të doganave shfuqizohet.

VI. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

Lidhja nr.1

STRUKTURA E PAGËS SË DOGANAVE

(Ndryshuar me VKM nr. 380, datë 14.7.2000; nr. 431, datë 11.6.2001)

K A T E G O R I A	EMËRTIMI	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E PROFESIONIT
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi në %	Shtesa për kualifikim në %	Shtesa për pozicion në lekë
	A.. Drejtor drejtorie në Departament Drejtor Drejtorie Rajonal	1	2% e PG për çdo vit pune		24 739
	B. Përgjegjës sektori Kryetar dege Inspektor	1	2% e PG për çdo vit pune		19 606
	C1.Specialist, Hetues dogane Drejtues turni	1	2% e PG për çdo vit pune		12 373
	C2. Doganier	1	2% e PG për çdo vit pune		9 747
	C2. Doganier	3			9 747
	D1. Doganier, shofer, regjistruar, sekretare, magaziniar, operator, laborant	3	2% e PG për çdo vit pune		7 948
	D2. Centralist, sportelist	3	2% e PG për çdo vit pune		7 948
	Sanitare, punëtor mirëmbajtjeje	4	2% e PG për çdo vit pune		4 565

LIDHJA NR.2

(Ndryshuar me VKM nr. 380, datë 14.7.2000; nr. 431, datë 11.6.2001)

Grupi	Paga në lekë
1.	9 000
2.	8 000
3.	6 000
4.	3 600